

FC 072



AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH  
INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE

CITTA' di CHIERI  
CONSIGLIERE COMUNALE  
*Vincenzo Cucci*

# KULTURA POPULLORE

№ 1

VITI 1980

Prof. Alesandro RENIS\*  
(Itali)

## VEGLAT DHE MUZIKA NË TREVËN ARBËRESHE

Të flasësh sot për muzikën arbëreshe, të kërkosn, pra, të shquash temat dhe simbolet që karakterizojnë shprehjet muzikore të bashkësive arbëreshe, do të thotë, para së gjithash, të përshkosh përsëri së prapthi rrugën e gjatë të kohës\*\*, të rilexosh vigjilent me sy dhe vesh të edukuar dukuritë, pa pasur mundësi të dokumentosh me muzikë të shkruar atë që je duke pohuar.

Tema është e guximshme, madje, do të thosha, përtej caqeve të çfarëdo niveli që të duash ta shtrosh dhe ta shtjellosh. Tradita gojore është dhe mbetet e vetmja gurrë nga mund të orvatemi për të kryer një analizë sadopak serioze dhe, të thuash, kompetente.

Po rrallëherë tradita gojore na është ruajtur në veshjen e saj buri-more, sepse koha, ashtu si ua nënshtron ligjeve të rrepta monumentet

\*) Mësues efektiv i italishtes dhe i latinishtes në Liceun klasik në Kastrovilari (Kozencë). Autori e ka shkruar artikullin posaçërisht për revistën tonë.

\*\*\*) Në vend të hyrjes së punimit A. Renis sjell një poezi që e ka shkruar vetë më 1981, bashkë me shënimin që po botojmë poshtë saj:

Kush botin mëmë  
ka të lërë sot  
mbiell zëmra gjak vetëhé  
e lot...

Kush po lënej n'dënj pis sulëdet  
ka pesqjindë viet  
sa zëmra ndaiti, sa mish,  
vërtet  
n'dër ca varranga t'Italisë  
la, mbalë një drizë  
mbi detit ksai iet  
për pesqjindë viet  
ka pesqjindë viet!

Gusht 1981

Vjersha që prin këtë punim do të këndojë atë pjesë prej nesh që ka humbur gjatë kohërave, së bashku me ato ndjenja dhe fjalë që kanë dalluar gjithnjë aq breza arbëreshësh. Janë ndjenja që kanë shijen e tokës së lënë, të vaditur me gjak, për një largim që s'ka të nesërme. Secili prej nesh dëshëron të kthehet në të kaluarën dhe të rimarrë atë pjesë të vetvetes që koha e Shqipërisë na e ka ruajtur të paprekur, me këmbëngulje, nga furia e kohës dhe e njerëzve. Ky punim përbën një hap të vogël drejt asaj që ka qenë e djeshmja jonë dhe që vetëm nëpërmjet formave të ripërtëritjes të na duket më pak e largët.

dhe dokumentet e qytetërimeve të së kaluarës, që u janë ekspozuar ndikimeve të jashtme të fuqishme, po ashtu nga brezi në brez, ekspozon shijen, veshin muzikor dhe rrjedhimisht vetë krijimin muzikor, shtrembërimet ose transformimet, herë të shpejta herë të ngadalshme. Atëhere pra, ligjërata jonë nuk do të mund të synojë tjetër veç veshjes muzikore, në mos burimore, të paktën sa të jetë e mundur më të lashtë dhe të vërtetë, me qëllim që të shquajmë me korrektësi modulët muzikore të popullit tonë.

Ne duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër: në qoftë se ajo që kemi pohuar pak më parë është e drejtë, atëhere është e vërtetë edhe që shtrembërimi më i shpejtë i shijes dhe i veshit tonë ka hyrë në bashkësitë me mjetet e komunikimit masiv dhe me shtrirjen e tyre në shtresa shoqërore sa më të gjera, pra në këto 30 vitet e fundit. Kjo na jep disi zemër në punën tonë që t'i japim një përgjigje të saktë tezës që mbrojmë, duke kapërcyer pak a shumë hendekun e këtyre 30 vjetëve të fundit. Për të kuptuar ndryshimet në interpretim dhe në shije gjatë kohës, mjafton të krahasojmë ekzekutimet para 30 vjetëve (kur i kemi) me ato të të njëjtave pjesë që bëhen sot nga brezat e rinj.

Para se të thellohemi në temë, është e nevojshme të analizojmë veglat kryesore që përdoren ende në bashkësitë tona, duke filluar nga më të thjeshtat, për të kaluar më pas në më të ndërlikuarat nga struktura, mënyra e përdorimit dhe nga efekti zanor.


*Fishkarualli* (kallami) është një element i «siringës» ose fyelli i Panit. Përbëhet nga një kallam i thatë (fig. 1, a) që ka një gjuhëz prej druri të fortë të punuar për t'u vënë në gojë, e cila vihet në njerën anë të kallamit (c) deri në vrimën nga del fryma (d). Vertikalisht hapen disa vrima të cilat shërbejnë për të moduluar zërin me anë të gishtave.


*Maçurrja* (macja). Quhet kështu, sepse kjo vegël jep një tingull që i përngjan mjaullitjes së një maceje. Përbëhet prej një shkopi të vogël prej druri të dafinës, që mund të ketë gjatësi dhe trashësi të ndryshme (fig. 2, a); ai ka një të prerë (b) prej disa centimetrash në një anë.

Në drejtim vertikal, në të çarën (c) bëhen dy zgjerime në anët kundrejt prerjes, ku futet një gjeth i njomë dafine që ndalon në bazën e së çarës dhe mbetet i lirë në pjesët e tjera gjatë dy anëve të hapjes, pasi janë hequr më parë pjesët e tepërta. Duke fryrë me kujdes mbi këtë gjeth dhe duke shtrënguar në mënyrë të përshtatshme buzët mbi skajet e drunjta të shkopit të vogël, përftohet një tingull që mund të modulohet me ndihmën e kavititetit që krijohet nga duart që mbështillen rreth veglës.


*Troka* është një rrotë e dhëmbëzuar (fig. 3) e cila fiksohet në një bosht (a) dhe rrotullohet mbi një gjuhëz të lakueshme (b), e cila, duke goditur një dhëmb pas tjetrit, shkakton disa tinguj ritmikë, që ndryshojnë sipas gjatësisë së gjuhëzës dhe trajtës së dhëmbëve. Është një vegël ritmike që përdoret nga e premtja deri në mesditën e së shtunës para pashkëve, kur këmbanat e kishave heshtin.

*Titaroti* ose fyelli (fig. 4) nuk ka vrima për variacionin e tingujve. Punohet nga lëkura e gështenjës, e fikut ose nga degë të ndonjë druri qumështor. Bëhet në kohën e pranverës, kur dalin degë të njoma






që kanë shumë qumësht. Fazat e ndërtimit janë këto: merret një degë e këtyre bimëve, sharrohet deri në madhësinë e dëshëruar (30/35 cm); ndahet me shumë kujdes lëkura nga pjesa e drunjtë, duke goditur anën e jashtme mbasi të jetë bërë një prerje rrethore; në këtë mënyrë përftohet një tub mbi të cilin bëhet një vrimë trekëndëshe (a) pak centimetra larg nga njëri prej skajeve. Nga pjesa e drunjtë, që ka dalë, sajojmë një gjuhëz (b) që futet në kavitetin e bandës (x), deri sa të mbyllë pjesërisht vrimën ku, duke takuar buzët, fryjmë duke i dhënë këndin e përshtatshëm për të nxjerrë tingullin. Duke mbyllur dhe duke hapur me anë të gishtit vrimën e daljes së ajrit (y), mund t'i japim tingullit një ritëm sipas dëshirës sonë. Natyrisht, vegla duhet të mbahet në drejtim horizontal mbi buzët.



*Fieta* (gjethja) është vetëm një gjethë e njomë misri, gruri ose e ndonjë bime tjetër, po, që mund të përthyer, e cila shtërngohet në njerën anë (fig. 5) ndërmjet dy gishtave të mëdhenj që mbahen paralelisht, dhe bllokohet në anën tjetër nga kurrizi i duarve. Tingulli përftohet duke shkaktuar me anë të frymës dridhje të gjethes, gjatë kavitetit të vogël që krijohet nga pozicioni i dy gishtave të mëdhenj. Gishtat e tjerë, që mbyllën në formë caliku, duke u mbledhur ose duke u hapur në mënyrë të përshtatshme, bëjnë të mundur që të modulohet një numër i kufizuar tingujsh.



*Karramunxa* (gajdja) njihet, prandaj nuk po e përshkruajmë. Ndonëse, si dhe vegla të tjera muzikore, nuk është karakteristike për ne arbëreshët, ne nxjerrim prej saj melodi dhe ritme që nuk dëgjoen në popuj të tjerë. Lexoni, për shembull, këtë hap ritmik vâllege.


KARRAMUNXA

*Libero*

*ect. a piacere*


Pjesa e parë është një modulim i zakonshëm i tingujve themelorë, të cilët ekzekutuesit tanë i nxjerrin para se të fillojë çfarëdo pjese. Pjesa e dytë është ajo që na intereson. Po e paraqitim në figurën e mëposhtme (6): a — bishti; b — caliku; c — gojëza për të fryrë; d — pjesa e drunjtë për të fiksuar kallamat (e) që kanë vrima.

Në mbyllje dëshërojmë të japim një shembull nga *arganeta* (saltarello), duke mos u ndalur në vegla të tjera (kitarrë, fizarmonikë, trekëndësh cigan, dajre me pafta etj.) që i kanë të gjitha krahinat. Kjo vegël lëshon tinguj të harmonizuar mbi themeloren kur mbyllet, dhe nota të harmonizuara mbi kadencën relative, kur hapet.



Është vegla që përdoret për tarantelën ose për të shoqëruar me ritëm të kadencuar disa «viershë» të improvizuara.

Veglat muzikore që përshkruam vazhdojnë të përdoren në bashkësitë tona. Është e qartë se nga tingujt muzikorë që mund të japin ato, disa kanë pretendime të mirëfillta muzikore, ndërsa të tjerat janë kthyer në mjete të thjeshta sidomos fshatarake për argëtim në duart e atyre që janë shumë të rinj dhe kënaqen duke nxjerrë ndonjë tingull. Megjithëse analiza që bëmë tani s'është përfundimtare, duhet të nënvizojmë këtë fakt: pjesa më e madhe e këtyre veglave është e tipit monodik, vetëm me një notë, ndonëse, siç është rasti i «fishkaruollit» mund të përftojë më shumë nota, po kurrësi harmonike.



### Tipare të muzikës arbëreshe

Nga sa thamë, është e lehtë të nxjerrim përfundimin se sa të lashta duhet të jenë këngët karakteristike monodike të bashkësive tona si «viershe», të shoqëruara ose jo nga tingujt e karramunxës, këngët e «valleve», ninullat etj. Sidoqoftë, këngët tona paraqesin përgjithësisht të gjitha tiparet e shprehjeve më të lashta muzikore të popujve që u shfaqën në brigjet e Mesdheut: egjiptasit, asirianët, babilonasit, ebrejtë, grekët, ilirët etj. Ato në fakt janë: a) instinktive, b) origjinale, c) me shtrirje të kufizuar melodike, ç) me ritëm të parregullt.

Janë këngë *instinktive*, sepse kanë lindur në rrethana të veçanta të jetës kolektive të bashkësive; muzika duket e krijuar nga një fuqi mbisunduese natyrore dhe mbetet e lidhur me kthimin në rrethanat për të cilat është krijuar: dasma, kremtime, veprimtari bujqësore ose me karakter më të përgjithshëm pune.

Janë b) origjinale, të papërziera, sepse nuk i nënshtrohen asnjë ndikimi teorik dhe transkriptimi i tyre me shenjat tona fonike dhe muzikore është gati gjithnjë i përafërt. Është muzikë kryesisht vokale, pra melodike dhe e lidhur ngushtë me fjalën, me të cilën krijon një shprehje të këngëzuar.

Kanë c) një shtrirje të kufizuar melodike. Intervalet më të përdorura në çdo këngë janë ato të sekondës ngjitëse ose zbritëse; muzika që përftohet priret nga përsëritja e disa notave ose e disa intervaleve që karakterizojnë natyrën e këngës.

Kanë ç) ritëm të parregullt. Në këngën e ngadalshme dhe me karakter të trishtuar, ritmi i lirë duket se ndjek dellin plot frymëzim të këngëtarit (ndonëse kjo dukuri e fundit nuk është veçori vetëm e muzikës arbëreshe). Kjo liri dhe parregullsi e ritmeve, në vetvete përbën një dokumentim lashtësie. Në muzikën popullore shqiptare ndeshen ritme në masa që janë të guximshme për veshin perëndimor, si: 7/8, 9/8, 11/8, 12/8 që, ndryshe nga masa në 12/8, ndërtohet rrebi  $5/8 + 7/8$  etj. Përkundrazi, në muzikën arbëreshe nuk gjejmë ritme të kësaj natyre, por ligjësi melodiqe të parregullta në strukturën e tyre intime. (E themi kalimthi së do të që me interes të hulumtohen shkaqet e thella të një zhvillimi më të ndryshëm të tillë në të dy trevat muzikore, në Shqipëri dhe në fshatrat arbëreshe. Kjo mund të bëhet objekt i një hulumtimi të mëvonshëm).

Në fakt, për këngët tona është i huaj stili *diastaltik* ose ekzistues për ndjenja heroike, stil karakteristik i tragjedisë, ndërsa mbetet mbi-sundues stili *sistaltik*, karakteristik për shfaqjen e dashurisë ose të brengës, në përgjithësi, si dhe stili *esikastik* (ose qetësues). Këtu duam të vëmë theksin në një koncept tjetër që lidhet drejtpërdrejt me këtë aspekt të fundit të shkrimit tonë.

Në edukimin e veshit muzikor të paraardhësve tanë ndikoi në mënyrë të theksuar muzika fetare e cila, nëpërmjet ritit grek bizantin, vazhdoi të kultivojë ligjërimin muzikor të tipit monodik sipas gjedheve të përcaktuara bizantine, nga mjaft aspekte shumë të afërta me botën arbëreshe.

Le të krahasohet, për shembull, *Evlogjtos i Kyrive* e ceremonive të vdekjes të tipit bizantin me *vajtmin* e trevës sonë arbëreshe. Po sjellim këtu (natyrisht pa fjalë) një *vajtim* që mund të dëgjohet ende në raste vdekjesh.

### Vajtim

#### VAJTIM



Kështu pra, të flasësh për muzikën arbëreshe, do të thotë para së gjithash të ngjitesh në të kaluarën, në rrugën e muzikës folklorike dhe në gjirin e saj të zbulosh dhe pra të kultivosh ç'është më autentike dhe ka arritur deri në ditët tona, me qëllim që këtë t'ua kalojmë të tjerëve.

Thamë, pra, se ligjërimi muzikor monodik, i realizuar me disa ritme dhe i zhvilluar sipas disa mënyrave të caktuara, është dëshmi e parë lashtësie. Në veçanti, tipari i përhershëm i këngëve tona është ky: një nga të pranishmit fillon temën, me kohë shumë të lirë duke u nisur nga një qëllim i dyfishtë: sugjeron argumentin (me fjalë të tjera, shtron pyetjen) dhe intonon pjesën nga ana muzikore. Më pas, kur mbyllet fraza, ndërhyjnë të tjerët, të cilët duke bërë një kor, shprehen gjithnjë kështu: shumica e pjesëmarrësve mban ison, ndërsa disa të tjerë ose të gjithë me radhë i përgjigjen zërit të parë, ftesës. Korifeu, pra, intonon,



shtron ligjërimin, dhe të tjerët e plotësojnë në përmbajtje dhe muzikë. Thamë «korifeu». Ky emër na çon drejtpërdrejt në botën e shfaqjes tragjike të Greqisë së lashtë, madje në zanafillën e kësaj shfaqjeje artistike të frymës helenike. Korifeu intononte dhe fillonte vallen, tregonte lëvizjet themelore. Pastaj kori plotësonte zhvillimin e tyre në përshtatje me përmbajtjen dhe ritmin që sugjeronte drama ose ashtu siç kërkonte korifeu të interpretohej. Kjo mënyrë shtrimi ose ekzekutimi është, sipas mendimit tonë modest, jo vetëm më e lira nga ritmi dhe nga lëvizjet, por edhe më e lashta e më popullorja. Në fakt është një punë me të vërtetë evështirë të hedhësh në pentagrame këto këngë, qoftë për faktin se objektivisht janë të vështira për t'u transkriptuar, qoftë edhe pse ai që këndon, interpreton lirisht herë pas here duke respektuar shumë pak ritmin. Le të sjellim tani ndonjë shembull:

## Doj t'isha

*a tempo molto libero* "quasi recitato" DOJ T'ISHA *a tempo*

Doj t'i-sha zog doj t'i-sha të fu-tu-ro-nja, o!

*a tempo libero*

zo-og doj t'i-sha të fu-tu-ro-nja o..... o!

*è castiellit* *Largo* *lunga pausa ad libitum* *insieme*

*sole* o! je-me vi-nj o! cu-uk mbi cu-u-uk

*pausa c.s.* *pausa c.s.*

sa t'vi-nj ti të gjë nj.o! tij fi-gu-ri-ri ne

*Lento ad libitum* *insieme*

Na ti ç'mu rri-te nd'aj-rit ma-lit na ti-... ç'mu

rri-te nd'aj-rit ma-lit o

Nuk mungojnë këngë që kanë dy aspekte: njera zbulon pjesërisht tjetrën, e cila, edhe pse e harmonizuar, është shumë e lirë. Kjo na detyron të pohojmë se në këtë pjesë, me kalimin e kohës, janë bërë ngjizje ndërmjet pjesëve të ndryshme muzikore dhe kompozicioni dëshmon për ndërhyrjen e një dore të stërvitur që e ka përpunuar atë, megjithëse këtë punë e ka bërë duke ndjekur traditën më të mirë. Ja një shembull:

## Ka mali...

KA MALI

*ben ritmato*

ka ma-li' mu ka-lla-ar e ma-mo-aj një nel e ze-zë

*Largo*

një ne-el' ze- - - - - zë një ne-el e ze- zë...o

Këngët më të njohura të bashkësive tona kërcënohen sot nga një rrezik i madh. Le të marrim si shembull këngën e Lungros «Garofolith...», që është ndër më të njohurat (por jo të lashtat) të visarit tonë muzikor. Arsyeya është shumë e thjeshtë. Është kënga që afrohet më shumë me muzikën bashkëkohore, kapet më mirë me vesh, është më e plota nga ana muzikore. Kjo i ka joshur shumë grupe folkloristike të japin interpretime gati gjithnjë të shtrembëruara, për shkak të ndërhyrjes së fleksioneve lokale dhe vetjake ose jo autentike, duke shkelur disa kalime e duke i kthyer ato në mënyrë të theksuar në llojin e muzikës napoletane. Këto këngë gjatë vitit lidhen me festa të caktuara, me kremtime popullore të ditës së martë pas pashkëve, me dasma, me kthimin e përvitshëm në ciklet e punëve bujqësore etj. Por rapsoditë më të njohura dhe më të shpeshta janë ato që tingëllojnë në veshin tonë në çdo rast, në çdo takim shokësh, madje rreth një tryeze të shtruar ku ka dhe ndonjë gotë verë të mirë, rreth një zjarri, ku rrotullohet një hell me mish të majmë nga fshati ynë, nën hijen plot freski të pyjeve malore tona, pranë një burimi... Në qoftë se është e vërtetë që kënga është një element që të lidh fort me shoqërinë, muzika folklorike të vllazëron dhe akordi vokal dhe liriko-muzikor çel rrugën dhe lehtëson marrëdhëniet ndërmjet grupeve. Arbëreshi e ndjen veten me të vërtetë vëlla me një tjetër, sidomos në këngët që kanë ato tipare karakteristike që kemi përmendur pak më lart.

Po të kalojmë pastaj në analizën e teksteve të këtyre këngëve, mund të pohojmë shtruar se ato nuk largohen fare nga temat e zakonshme të folklorit. Gati gjithnjë trajtohet tema e dashurisë me aspektet e saj të ndryshme: herë kontrast, herë vuajtje e brengë, herë ndjenjë ekzaltuese që shfaqet në gëzimin e të jetuarit, herë pritje gjithë mundim e së dashurës; herë gëzim i madh, herë ankim i përvajshëm, por gjithnjë me një begati simbolesh dhe larmi figurash të përforcuara nga tradita ose të improvizuara nga frymëzimi i çastit, në përkrahje me veçoritë e rrethanave. Nuk mungon vajtimi i një populli të shpërngulur që shikon me dëshirë e dashuri një të kaluar të lashtë që nuk mund të kthehet. Ja pse pjesa më e madhe e këngëve tona është në shkallë minore, që nga ana muzikore priret të shprehë vajtım, ndjenja patetike sentimentale.

Është me vend të çelim këtu një parantezë për të shpjeguar për shembull, pse në bashkësitë tona njihen më pak këngët në minor sesa ato në maxhor. Pa harruar se, si rregull, këngët tona në minor muzi-

kalisht, e pra me vesh, kalojnë më me vështirësi nga brezi në brez, duhet bërë edhe një saktësim tjetër: kontakti me realitetin folklorik të Italisë së Jugut ka sjellë depërtimin e një vegle — *arganeta* — që, siç e kemi parë, është një vegël me dy, katër, tetë basa, me pozicion kadencë dhe dalje (me përjashtim të atij me tetë basa) në maxhor. Kjo gjë ka shkaktuar gjatë kohës përhapjen e këngëve në maxhor, sepse vegla në fjalë, që karakterizohet nga tinguj të fortë që mbizotërojnë mbi të tjerët, është përdorur gjithnjë me lehtësi nga këngëtarë të improvizuar dhe, shpesh, jo të zotë. Pra, vegla ia ka punuar keq traditës, duke sjellë një seleksionim të vërtetë jo të cilësisë, por të llojit dhe duke kositur një pjesë të madhe të visarit tonë muzikor. Lexoni këto dy pjesë që janë krejt njëjloj edhe në ndërtimin e periudhës muzikore, edhe në vargjet... Por e dyta, në minor, praktikisht është zhdukur; e para, në ton maxhor, është ndër më të njohurat.

KOPILE... (tono maggiore)

Ko-pi-le moj ko-pi-le ko-pi-le moj ko-  
 pi-(le) ko-pi-le moj ko-pi-le ç'i m'llam-ba-ri-si  
 o o o ç'i m'llam-ba-ri-sin ect

KOPILE... (tono minore)

ko-pi-le moj ko-pi-le ko-pi-le moj ko-pi-(le) ko-  
 pi-le moj ko-pi-le ç'i m'llam-ba-ri-sin o o  
 o ç'i m'llam-ba-ri-sin ect

Ja, pra, si një visar, përveç varfërimit të përditshëm nga veprimi dëmtues i kohës, varfërohet në vetë çastin kur ekzekutohet, sidomos me gërnetën. Kjo vegël, në fakt, jo vetëm nuk lejon kalime në minor, por me kalimin e kohës e detyron veshin dhe shijen të ngujohet në disa

skema të rregullta e të ngurta dhe e tërheq ekzekutimin, në mënyrë gjithnjë më të prerë, në trevën e folklorit të Italisë së Jugut, siç kemi thënë, në atë shkallë saqë afria ndërmjet dy trevave folklorike po merr trajta gjithnjë e më të ngjashme. duke dëmtuar rëndë karakterin specifik të këngëve tona.

I shtrojmë këto çështje që të shpejtojmë të shpëtojmë nga veprimi grabitqar i kohës atë që mund të shpëtohet, duke shpresuar që të kthejmë përsëri në jetë atë që është harruar, duke kërkuar të zbulohet ajo pjesë e së kaluarës që nuk ka vdekur dhe jeton ende sot ndër ne dhe që përbën elementin themelor të identitetit tonë si arbëreshë. Me një frymë të tillë ne duam t'u tregojmë njerëzve që e kultivojnë këtë thesar dhe të tjerëve të kenë mendjen për këtë rrezik që na kanoset. Së fundi me këtë frymë sugjerojmë një metodë pune.

Rreziku më i madh për karakterin autentik dhe origjinalitetin e këngëve tona (këto duhen ruajtur me çdo kusht dhe me rrugë të shumta) vjen nga krijimi dhe shumimi, në çdo bashkësi arbëreshe, i grupeve të ndryshme folkloristike. Në pamje të jashtme kjo që thamë mund të duket kontradiktore; zakonisht, sa më shumë njerëz ta kultivojnë artin, aq më të mëdha janë mundësitë e ruajtjes. Kështu duhet të ishte. Them «duhet!». Përkundrazi, çfarë po ndodh? Në shumicën e rasteve, grupet lindin në mënyrë të paorganizuar, nën drejtimin e përgjegjësve vullnetmirë, të cilët zotërojnë një farë bagazhi të përshtatshëm për një ekzekutim me efekt, pasi që kanë bërë një farë pune për ngjizjen e këngëve më të njohura të bashkësive të ndryshme arbëreshe; prandaj nuk është i rrallë rasti kur ai visar, që duhet zgjeruar duke u pasuruar me elemente nga e kaluara, të ndalet në gjërat më të reja, të cilat i përkasin gjithmonë, ose gati gjithmonë, muzikës së harmonizuar mbi akorde, me siguri, të huaja për kulturën tonë. Ky dëm që i shkaktohet visarit folklorik është ndoshta më i rëndi. Në fakt programi (le ta quajmë kështu) i grupeve të ndryshme priret gjithnjë e më shumë të njësohet, ka variante shumë të pakta. Nuk mund të lëmë pa theksuar një dëm tjetër; fakti që këngë të Frashinetos, p.sh., ose të Lungros kalojnë vesh më vesh te interpretuesit e S. Demetrios (Shën Mitrit), fjala vjen, ose të Çivitas, pikërisht sepse nuk janë transkriptuar me veshjen muzikore përfundimtare, shkakton një farë prishjeje të interpretimit dhe të ekzekutimit që nuk e ndihmon fare çështjen tonë. Po, atëhere, të mos ketë fare grupe folklorike? Të mbyllim çdo shteg lidhur me të renë? Po të mbrojmë këtë mendim, do të pretendonim nga të gjithë arbëreshët një përgatitje të veçantë për një folklor të bazuar në studime, duke i thënë «lamtumirë» spontaneitetit, krijimtarisë së çastit dhe të individit.

Sipas mendimit tonë, një nga rrugët që duhen ndjekur do të mund të ishte kjo. Para së gjithash duhet të lëvrohet materiali muzikor që është mbledhur deri më sot, duhet të ndahet sipas gjinive dhe fshatrave nga e ka zanafillën; të realizohet transkriptimi muzikor, në mënyrë që pjesët të kenë të fiksuar një veshje përfundimtare dhe, me anë të krahasimit të ekzekutimeve, kjo të jetë veshja e tyre e parë. Më pas do të duhej mbledhur në shtyp gjithë lënda dhe t'u besohet grupeve të ndryshme folklorike. Në këtë kohë le të ndërhyjnë drejtuesit e ndryshëm të grupeve, të cilët duhet të zotohen që muzikantët e tyre t'i mësojnë pjesët ashtu siç janë krijuar, siç na i ka besuar tradita më autentike dhe po

ashtu t'i ekzekutojnë. Mund të më thonë se folklori është muzikë popullore dhe fryma popullore zhvillohet gjatë kohërave bashkë me traditën, zakonet e kulturën. Atëherë, si edhe pse folklori ynë nuk duhet t'i përshtatet shijes së kohës? Pra, kërkimi i së resë bëhet i nevojshëm. Kështu hapet një rrugë e re dhe tërheqëse për përgjegjësit e grupeve të ndryshme folklorike. Mund të punohet mbi të vjetrën duke e veshur me të renë, duke e harmonizuar sipas dëshirës, por grupet folklorike duhet të zotohen të këndojnë pjesën e përpunuar një herë në veshjen e saj origjinale dhe më pas në përshtatjet e saj të ndryshme. Në këtë mënyrë, e vjetra nuk harrohet dhe e reja kënaq shijen e ndryshuar muzikore të brezave të rinj. Kulturë, pra, dhe shfaqje, vlerësim i së kaluarës dhe shartim i së resë në trungun e vjetër të lashtësisë. Ky është një mendim. Me kohë mund të bëhet diçka më shumë se një mendim.